



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

Nr. 40 prot.

Kamëz, më 23. 4. 2026

V E N D I M
Nr. 35 .Datë 23/4 2026
M B I

“NJË NDRYSHIM NË VKB NR.74 DATË 26.07.2024 “MIRATIMIN E KRIJIMIT TË ANSAMBLIT TË VALLEVE “ARTAN CUKU”, KRIJIMIT TE FORMACIONIT ORKESTRAL DHE PAGESËS SË TYRE NËPËRMJET HONORAREVE”

Këshilli Bashkiak Kamëz i mbledhur sot më datë 23.04.2026, pasi mori në shqyrtim Projekt-vendimin Nr.28 Datë 23.04.2026 në mbështetje të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”; Ligjit nr. 10352, datë 18.11.2010 “Për artin dhe kulturën”; VKB-së nr. 74, datë 26.07.2024. “Miratimin e krijimit të Ansambilit të Valleve “Artan Cuku”, krijimit te Formacionit Orkestral dhe pagesës së tyre nëpërmjet honorareve” VKB-së nr. 90, datë 17.12.2025, “Për miratimin e detajimit të buxhetit për vitet 2026-2028”, Këshilli Bashkiak Kamëz”;

V E N D O S I:

1. Miratimin e krijimit të Ansambilit të Valleve “Artan Cuku” me përbërje prej 15 (pesëmbëdhjetë) çiftesh, të cilët do të performojnë në aktivitete që organizon Bashkia Kamëz, nëpërmjet Drejtorisë së Qendrës së Kulturës.
 - 1.1 Secilit valltar do t’i lidhet një Akt-Marrëveshje për shërbimin e ofruar.
 - 1.2 Paga do të jetë kundrejt shumës 10 000 (dhjetë mijë) lekë, për çdo shfaqje që valltari merr pjesë.
 - 1.3 Fondi është planifikuar në buxhetin e vitit 2026 në strukturën buxhetore Gr. 0, Kap. 5, Prog. 08220, Llog. 602.
2. Miratimin e dhënies së honorareve për grupin e Formacionit Orkestral, të cilët do të performojnë në aktivitetet që organizon Bashkia Kamëz, nëpërmjet Drejtorisë së Qendrës së Kulturës.
 - 2.1 Secilit instrumentist do t’i lidhet një Akt-Marrëveshje për shërbimin e ofruar, në kuadër të aktivitetit pjesëmarrës.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

- 2.2 Instrumentisti do të paguhet në shumën prej 10 000 (dhjetë mijë) lekë, për cdo shfaqje që merr pjesë.
- 2.3 Fondi është planifikuar në buxhetin e vitit 2026 në strukturën buxhetore Gr.0, Kap. 5, Prog. 08220 Llog. 602.
3. Miratimin e dhënies së honorareve për Kantot, të cilët do të performojnë në aktivitetet që organizon Bashkia Kamëz, nëpërmjet Drejtorisë së Qendrës së Kulturës. ▼
- 3.1 Secilit kanto do t'i lidhet një Akt-Marrëveshje për shërbimin e ofruar.
- 3.2 Pagesa do të jetë kundrejt shumës 10 000 (dhjetë mijë) lekë, për çdo shfaqje që kanto merr pjesë.
- 3.3 Fondi është planifikuar në buxhetin e vitit 2026 në strukturën buxhetore Gr. 0, Kap. 5, Prog. 08220, Llog. 602.
4. Shfuqizimin e Vendimit nr. 74, datë 26.07.2024. "Miratimin e krijimit të Ansambllit të Valleve "Artan Cuku", krijimit të formacionit orkestral dhe pagesës së tyre nëpërmjet honorareve".
5. Për zbatimin e këtij vendimi do të ngarkohen Drejtorja e Qendrës së Kulturës dhe Drejtorja e Financës dhe Buxhetit.
6. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55, të Ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore".

KRYETAR KËSHILLI
Hysen KOLDASHI

